

Njoftim

Sot, më datë **15.06.2023**, ora **15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Esmeralda Xhili (Relatore);**
- 2. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.31 Regj.Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditësa: - Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.
- Shkëlqim Hoxha, kandidat për kryetar bashkie Rrogozhinë, përfaqësuar nga Av. Viktor Gumi.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Ina Osmanaj, Erdal Mema dhe Blendi Kodra.

Person i interesuar: Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Eridian Salianji.

Objekti: -Ndryshimin e Vendimit nr.174, datë 06.06.2023 të Komisionit për Ankimimet dhe Sanksionet (KAS) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Miratimi i “Tabelës së re Përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkie Rrogozhinë”, duke mos përfshirë rezultatit zgjedhor të qendrës së votimit nr.2224/01 Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Rrogozhinë.
- Shpalljen fitues për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë z. Shkëlqim Hamid Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë”.

Baza ligjore: Neni 145, neni 152, neni 153, neni 155 dhe vijues të Kodit Zgjedhor.

me Vendimin Nr. 28, datë 15.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Shfuqizimin e vendimit Nr.174, datë 06.06.2023 të KAS.
3. Shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr. 43, për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 15.06.2023.

Tiranë, më 15.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë